



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.A.nr.34/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Zenel Leku, kryetar, Rrustem Thaqi dhe Beshir Islami, anëtarë, në çështjen juridike të dënuarit F.R., nga P., sipas kërkesës për lirim me kusht, duke vendosur sipas ankesës së të dënuarit, të paraqitur kundër vendimit të Panelit për Lirim me Kusht, PLK.D.nr.395/24 të datës 29.07.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 03.09.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa e të dënuarit F.R., nga P., e paraqitur kundër aktvendimit të Panelit për Lirim me Kusht, PLK.D.nr.395/24 të datës 29.07.2024.

A r s y e t i m

Paneli për Lirim me Kusht me aktvendimin PLK.D.nr.395/24 të datës 29.07.2024, në pikën e parë të dispozitivit ka refuzuar kërkesën për lirim me kusht e të dënuarit F.R., nga i ati H., dhe e ëma H., e gjinisë B., i lindur më datë .././....., në P., rr. ".....", nr. ., me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës. Në pikën e dytë të dispozitivit është vendosur që kërkesa për lirim me kusht i refuzohet për periudhën kohore prej tre (3) muaj, e njëjta mund të rishqyrtohet pas kalimit të këtij afati.

Kundër këtij vendimi i dënuari me kohë ka paraqitur ankesë, duke shprehë pakënaqësi për refuzim të kërkesës dhe duke pretenduar se ka plotësuar kushtet ligjore për lirim me kusht, e gjithashtu ka theksuar se ka sjellje të mira dhe se nuk ka pasur ndonjë vërejtje apo shkelje disiplinore. Pastaj ka theksuar se deri në përfundim të dënimit i kanë mbetur edhe 7 muaj dhe se mendon se ka arritur risocializimin, e po ashtu ka kërkuar nga gjykata që ti mundësoj lirim me kusht, pasi që gjatë vuajtjes së dënimit i ka vdekur babai dhe se nënën e ka të moshuar, e cila jeton vetëm me motrën e tij, andaj propozon që kërkesa e tij për lirim me kusht të aprovet si e bazuar.

Me përgjigje në ankesë, Paneli për Lirim me Kusht e ka kundërshtuar në tërësi ankesën e të dënuarit, ka propozuar që ankesa e paraqitur të refuzohet si e pabazuar, kjo pasi që të

dënuarit i duhet ende kohë për të vlerësuar qëndrueshmërinë e sjelljeve të tij gjatë mbajtjes së dënimit dhe se nuk ka konstatim nga ekipi profesionist i Qendrës Korrektuese në D., se është arritur risocializimi i tij, ndërsa vendimi i kundërshtuar të vërtetohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me vendimin e atakuar, në mbështetje të nenit 117 paragrafi 11 dhe 12 të Ligjit Nr. 08/L-132, për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, shqyrtoi ankesën e paraqitur nga i dënuari, vendimin e ankimuar, si dhe shkresat e lëndës, dhe gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e dosjes së të dënuarit, rezulton se i njëjti është shpallur fajtor për shkak të veprave penale: Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve dhe substancave psikotrope nga neni 267 paragrafi 2 lidhur me nenin 35 dhe 77 të KPK-së dhe Grabitje nga neni 317 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 dhe nenin 31 të KPK-së. Në raportin ligjor për të dënuarin vërtetohet se data e përfundimit të dënimit është caktuar më 13.03.2025 dhe nga llogaritja e dënimit rezulton se të dënuarit i kanë mbetur për t'i mbajtur edhe 7 muaj, 14 ditë.

I dënuari përmes Institucionit të Qendrës Korrektuese në D., ku është në vuajtje të dënimit me burg, më datë 01.07.2024, ka parashtruar kërkesë për lirim me kusht me arsyetimin se gjatë mbajtjes së dënimit, me sjelljet e tij është arritur risocializimi i tij dhe janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për lirimin e tij me kusht.

Paneli për Lirim me Kusht në seancën e mbajtur më 29.07.2024, pasi e shqyrtoi dosjen e të dënuarit, përkatësisht raportin përmbledhës të përpiluar nga Ekipi Profesionist i Institucionit Korrektues, deklaratë - premtimin lidhur me mbikëqyrjen e të dënuarit pas lirimit me kusht, ashtu siç është përcaktuar në nenin 116 të Ligjit Nr.08/L-132 mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe nenin 15 të Rregullores Nr.12/2023 për Punën e Panelit për Lirim me Kusht dhe pas vlerësimit të tërësishëm të çështjes, të njëjtën e ka refuzuar si të pa bazuar.

Në raportet e tjera të përpiluara nga ekipi profesionist i Qendrës Korrektuese, rezulton se i dënuari ka filluar përmirësimin e sjelljeve të tij, përkatësisht nuk ka të dhëna për shkelje të reja disiplinore. Ekipi profesionist i Qendrës Korrektuese ka konstatuar të mesme rrezikshmërinë për recidivizëm dhe ndaj komunitetit. Në të dhënat për realizimin e programit për trajtimin e të dënuarit, konstatohet se i dënuari edhe nga shqyrtimi paraprak i kërkesës për lirim me kusht vazhdon të jetë i angazhuar me punë, nuk ka marr pjesë në programe rehabilituese apo aftësimi profesional. Po ashtu, sipas ekipit profesionist të Qendrës Korrektuese procesi i risocializimit ka rrjedhur normalisht, ku mbajtja e dënimit ka ndikuar pozitivisht.

Në arsyetim të vendimit Paneli ka konstatuar se ka vlerësuar plotësimin e kushteve të përcaktuara në nenin 90 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, si dhe rrethanat e tjera që ndikojnë në lirimin me kusht të personit të dënuar që parashihen në nenin 11 të Rregullores Nr.12/2023 për Punën e Panelit për Lirim me Kusht, si: përshkrimin e personit të dënuar për veprën penale, gjendjen fizike dhe psikike të tij, qëndrimin e personit të dënuar ndaj viktimës, sjelljen e mirë gjatë burgimit, përkatësisht të dhënat nëse është shqiptuar masë disiplinore ndaj tij gjatë vuajtjes së dënimit, rrethanat e tij familjare dhe të kaluarën shoqërore, planet e të dënuarit pas lirimit, pranimi i kontrollit dhe mbikëqyrjes nga ShSK, ekzistenca e një

rreziku të përgjithshëm për shoqërinë/komunitetin, programet rehabilituese të ndjekura nga personi i dënuar, vlerësimin e progresit të arritur te i dënuari në planin individual të rehabilitimit dhe rrethanat e tjera të vlerësuara nga paneli që tregojnë se i njëjti nuk do të kryej vepër penale.

Paneli pas shqyrtimit të dosjes, vlerësimit të kushteve dhe rrethanave të caktuara në rregullore, konstatoi se të dënuarit i duhet ende kohë për të mbajtur dënimin në mënyrë që të vlerësohet sjellja e të njëjtit. Kategorizimi se ekziston rrezikshmëria për recidivizëm dhe ndaj komunitetit, tregon një indikator që për të dënuarin duhet ende kohë për të vlerësuar rrezikshmërinë e mbetur. Po ashtu, nuk ka konstatim nga ekipi profesionist i Qendrës Korrektuese se është arritur risocializimi, andaj marr parasysh faktin se risocializimi është një proces që siguron se i dënuari është i gatshëm që të riintegrohet në shoqëri pa rrezik për t'u kthyer në veprime të paligjshme dhe se mungesa e një konstatimi të tillë nga ekipi profesionist i Qendrës Korrektuese tregon se procesi i risocializimit nuk është përfunduar ende. Prandaj duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana, Paneli ka ardhur në përfundim se nuk është arritur qëllimi i ekzekutimit të sanksionit penal i paraparë sipas dispozitës së nenit 38 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe nenit 5 dhe 6 të Ligjit Nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, ku kërkesa e të dënuarit u refuzua për periudhën kohore prej 3 muaj, me të drejtë rishqyrtimi pas kalimit të këtij afati.

Në një gjendje të tillë të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm vendimin e ankimuar, pasi që i njëjti është në tërësi i bazuar në ligj dhe me këtë rast u pranuan si të bazuara të gjitha konstatimet faktike dhe juridike të Panelit për Lirim me Kusht. Refuzimi i kërkesës për lirim me kusht i ushtruar nga i dënuari, është i mbështetur në dispozitat ligjore të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, si dhe në Rregulloren nr.12/2023, duke i shqyrtuar të gjitha rrethanat që parashihen me dispozitat ligjore nga ligjet e sipërcituara dhe Rregullorja nr.12/2023. Gjykata Supreme vlerëson se ende nuk janë plotësuar komulativisht të gjitha kushtet ligjore që i dënuari të përfitoj nga lirimi me kusht, kjo për faktin se ende nuk është bërë risocializimi i tij në mënyrë të plotë ashtu siç kërkohet me dispozita ligjore. Përveç kësaj, kjo gjykatë vlerëson se me të drejtë janë vlerësuar kriteret nga paneli marrë për bazë nenin 38 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe nenin 5 dhe 6 të Ligjit Nr.08/1-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, kjo pasi që ende ekziston rrezikshmëria e përgjithshme shoqërore dhe për faktin se ende nuk është arritur qëllimi i ekzekutimit të sanksionit penal bazuar në dispozitat e lartcekura, e po ashtu për faktin se ekipi profesionist i Qendrës Korrektuese nuk ka dhënë konstatim se është arritur risocializimi i plotë te i dënuari, e duke marrë për bazë faktin se procesi i risocializimit ende nuk ka përfunduar, e po ashtu rrezikshmërinë për recidivizëm, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Supreme vlerëson se refuzimi i kërkesës nga ana e Panelit për Lirim me Kusht është bërë pas vlerësimit të secilit kriter të paraparë me nenin 11 të Rregullores, nr.12/2023, për Punën e Panelit për Lirim me Kusht, andaj një vendim të tillë e mbështet edhe kjo gjykatë. Kjo gjykatë konstaton se refuzimi i kërkesës nuk prejudikon mënyrën e vendosjes në rast të përsëritjes së kërkesës pas kalimit të afatit prej 3 muaj, ashtu siç është përcaktuar në vendimin e panelit, andaj pretendimet ankimore të paraqitura në këtë drejtim u vlerësuan si të pabazuara.

Për arsyet e paraqitura më lart, në bazë të nenit 117 paragrafi 11 dhe 12, të Ligjit nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

AA.nr.34/2024, më 03.09.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari
Zenel Leku